

Njoftim Publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr. 350/02-89684/23 dt. 04.05.2023, në emër të pronarit Fidan Haradini nga Prishtina, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kriteret për ndërtim, përkatësisht për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës investive/ Impiant për prodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë përmes djegies së vegjetacionit- Biogas, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë, gjegjësisht në kuadër të parcelës kadastrale me nr. 01405-2, ZK Dabishec. Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 12.05.2023 deri më 26.05.2023, në e-mail adresën: urbanizimprishtine@rks-gov.net

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Destinim i propozuar për tokë ndërtimore/ Ndërtesë investive- Impiant për fermentimin e mbetjeve- Biogas
b. Vija rregulluese	Sipas Planifikimeve për rrugë
b. Vija ndërtimore	Sipas Projektit~15m'
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	10.38 m'/~14.20m' 10.38 m'/~20.70m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	~ 30 m' ~ 37.00 m' ~ 14.60 m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	ISHP= 20-30 % , e lejuar
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	ISPN= 0.6-0.8 është propozuar me 20%
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	ISHGJ= 40 % , i lejuar është propozuar me 70%
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	ISHPN=60 % , e lejuar
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve	Propozuar 20 VP në Parter/
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po/
a. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	/
b. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
c. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë me të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
d. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përdoren në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari:

